

VENDIM
Nr.383, datë 25.5.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL TË
PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE,
PËR 10 BASHKI DHE 12 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 10 bashki dhe 12 komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi në vlerën 43 810 523 lekë (dyzet e tre milionë e tetëqind e dhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë, të përballohet nga fondi i kontigjencës i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha